



**VENDIM**

**Nr. 05, Datë 23.04.2013**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË KONKURSEVE TË PRANIMIT DHE KRITEREVE TË  
KONKURRIMIT NË FAKULTETIN E MUZIKËS NË UNIVERSITETIN E ARTEVE PËR VITIN  
AKADEMIK 2013 - 2014**

Senati i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 23.04.2013, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve, bazuar në ligjin nr. 9741, date 21.05.2007, i ndryshuar si dhe Statutin e Universitetit të Arteve,

**VENDOSI**

1. Miratimin e Rregullores së konkurseve të pranimit dhe kriterëve të konkurrimit në Fakultetin e Muzikës në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2013 - 2014 sipas dokumentit bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Asoc. Artan PEQINI

Prof. Sokol SHUPO

Prof. Gazmend LEKA

Prof. Asoc. Haig ZACHARIAN

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Astrit SELITA

Prof. Asoc. Sadik SPAHIJA

Miranda BAKIASI

Prof. Fatmir MIZIRI

Lije PLAKU ADEMI

Ramazan GURRA

Enisa VRENOZAJ

Kristina AGO

Albjan VUKA





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKES

Adresa: Biv. "Dëshmoret e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri, Tel: +355 42 247 596, www.uan.edu.al

MIRATOHET  
Rektori  
Prof. Petrit Malaj

# RREGULLORE

Për zhvillimin e Konkurseve të Pranimit

në

Fakultetin e Muzikës në UA

Viti akademik 2013 – 2014

*Tiranë, 2013*





Në zbatim të Ligjit Nr. 9741, Nr.9741, dt. 21.5.2007, i ndryshuar me Ligjin Nr.10 307, datë 22.7.2010 "Për Arsimin e Lartë në RSH", Neni 33, "Pranimi në ciklin e parë të studimeve", pika 5; Kreu II, „Studimet në Ciklin e Parë“, Neni 62 "Pranimi në ciklin e parë të studimeve", Konkursat e Pranimeve (KP) për vitin akademik 2012-2013 në Fakultetin e Muzikës (FM) zhvillohen si më poshtë:

#### 1. Pranimi i kandidatëve

1.1. Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Muzikës (FM) të UA mbështetur në rezultatin të Konkurseve të Pranimiit që zhvillohen pranë FM, sipas kriterëve të miratuara nga MASH, si dhe sasisë së përgjithëshme të pikëve të "Maturës Shtetërore".

1.2. Pikët ndahen si më poshtë:

Gjithsej	300 pikë
Matura Shtetërore	20% të totalit
Konkursi i Pranimiit	80% të totalit
Pragu minimal i fitimit të të drejtës së studimit	25% të totalit

1.3 Tarifat e regjistrimit për konkurim arkëtohen nëpërmjet sistemit bankar ose zyrave të Postës Shqiptare, për llogari të UA.

#### 2. Procedura e organizimit dhe mbarëvatjes së konkursit.

1.1. Dekani i Fakultetit merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Vlerësimit të Kandidatëve (KVK) për Programet përkatëse mësimore. Përbërja e KVK shpallet një ditë para fillimit të konkurimit përkatës.





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKES

Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kosovës", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 241 595 www.ujaf.edu.al

1.2. Në përbërje të KVK mund të marrin pjesë punonjës mësimorë të përhershëm të departamenteve përkatëse, punonjës mësimorë të ftuar të FM, si dhe titullarë të fushës përkatëse.

1.3. Në përbërjen e KVK nuk mund të jenë pedagogë apo anëtarë të tjerë të cilët kanë konflikt interesi me institucionin e Konkursit të Pranimiit (KP).

1.4. Në mjediset ku zhvillohen KP nuk lejohet hyrja e personave pa autorizimin e titullarit të FM.

1.5. Të gjitha procedurat e konkurimit që kanë të bëjnë me organizimin dhe administrimin, vëzhgohen prej Grupit të Kontrollit të Zbatimit të Procedurave (GKZP) të ngritur me urdhër të titullarit të Fakultetit.


1.6. Në fund të konkurimeve, GKZP i përcjell titullarit të FM një raport mbi mbarëvajtjen e konkurimeve.

1.7. Të gjitha procedurat e konkurimit që kanë të bëjnë me organizimin dhe administrimin, vëzhgohen prej grupit përkatës të ngritur nga Rektorati.

### **3. Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurimit.**

3.1. Kanë të drejtë të hyjnë në KP vetëm kandidatët që përmban lista e dërguar nga MASH.

3.2. Lejohen të hyjnë në KP vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurim. Ata duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimj (kartë identiteti, pasaportë për jashtë shteti ose certifikatë me fotografi të vulosur). Kandidatët që nuk kanë asnjë prej këtyre dokumentave, nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.





3.3. Përpara se sa të marrë pjesë në KP, kandidati konkurent duhet të ketë depozituar pranë sekretarisë mandat-pagesën e kryer në llogari të institucionit, mbështetur në Udhëzimet e MASH.

3.4. Sekretaria mësimore i dorëzon Kryetarit të KVK përkatës materialet me listat e ardhura nga MASH.

3.5. KP zhvillohen në ambientet e FM. Periudha kohore në të cilën zhvillohen KP përcaktohen nga MASH.

3.6. Kalendari i hollësishëm i zhvillimit të KP (orart, mbjentet etj.) shpallen në mjediset e FM të paktën pesë ditë përpara fillimit të periudhës së konkurimeve.

3.7. Ditën e parë të konkursit, pasi të jenë sistemuar në mjediset e zhvillimit të tij, Kryetari i KVK përkatës u bën të ditur kandidatëve Rregullat e Konkurimit.

#### 4. Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

4.1. Vlerësimi i çdo kandidati bëhet prej KVK përkatës, përbërja dhe numri i të cilit përcaktohen nga titullari i Fakultetit mbështetur në propozimet e përgjegjësve të Departamenteve. Në asnjë rast numri i anëtarëve të KP nuk duhet të jetë më i vogël se tre.

4.2. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë. Anëtarët e KVK disponojnë, për secilin kandidat një maksimum prej 240 (dyqint e dyzetë) pikësh (80% të totalit të KP).

4.3. Ndarja e pikëve të vlerësimit sipas fazave të KP ose kërkesave (zërave) të tij kryhet (përkatësisht) sipas ndarjes së parashikuar në Kriteret e Konkurimit dhe me Vendim ad hoc të KVK.

4.3. Materialet përfundimtare të KP dorëzohen në MASH në dy forma:





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKES

Adresa: Biv. 'Dëshmorët e Kombit', Sheshi 'Nënë Tereza', Tiranë Shqipëri; Tel: +355 42 247 890; [www.art.edu.al](http://www.art.edu.al)

4.3.1. Në formë elektronike, në një CD të firmosur me marker nga dekani

4.3.2. Në letër, të firmosura nga anëtarët e KVK përkatës.



Prof. Sokol Shupo  
Dekani i FM



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKES

Adresa: Biv. Dëshmoret e Kombit, Sheshi "Nene Tereza", Tiranë Shqipëri. Të: +355 42 247 595 www.uiaf.edu.al

No. 179 Prod.

Miratohet

Prof. Petrit Malaj

Rektor

## RREGULLORE

për

**Ciklin e Dytë të Studimeve**

**"Master Shkencor"**

**"Master i Arteve të Bukura"**

**"Master Profesional"**

Tiranë 2013



Prof. Sokol Shupo

Dekan



## Neni 1

### Mbështetja ligjore

Hapja Programit të Studimit të Ciklit të Dytë (Master i Arteve të Bukura, Shkencor dhe Profesional) mbështetet në:

1. Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, Nr.9741, datë 21.5.2007 i ndryshuar me Ligjin Nr.10 307, datë 22.7.2010, Neni 26 "Ciklet dhe titujt e studimeve universitare", pika 1.2.1. "Programet e studimeve "Master i shkencave" ose "Master i arteve të bukura", "Master Profesional".

2. Statutin e Akademisë së Arteve, Kreu III, "Studimet në Ciklin e Dytë", Neni 67, "Programet e ciklit të dytë të studimeve "Master i Shkencave", "Master i Arteve të Bukura", "Master Profesional"; Neni 31 "Këshilli i Fakultetit" Pika 1b; Neni 9 "Senati Akademik" pika 2e.

## Neni 2

### Qëllimi

1. Programi i Studimeve i Ciklit të Dytë ("Master i Shkencave", "Master i Arteve të Bukura", "Master Profesional") synon:

2.1. Të ofrojë arsimim dhe trajnim të një niveli më të lartë shkencor ose profesional

2.2. Të përgatisë punonjësit mësimorë të specializuar të zhvillimit të këtyre lëndëve pranë FM përmes një programi intensiv dhe të drejtuar.

2.3. Të formojë specialiste shumë të kualifikuara në fushën e interpretimit për t'ju përgjigjur jo vetëm kërkesave më të ngutshme aktuale por edhe kërkesave të perspektives të zhvillimit të integruar të kësaj fushe në Shqipëri.







2.2.4. Te formoje specialistë të cilet t'i përgjigjen më së miri kërkesave të tregut të punës lokal dhe global, duke u orientuar në profilizime të ngushta profesionale teorike dhe praktike.

Programi përmban në vetvete disiplina të një trangu të përbashkët formues të karakterit teorik e praktik, njëkohësisht edhe disiplina më të ngushta profesionale, me një shtrirje që ndryshon nga një program tek tjetri në varësi të veçorive specifike të fushës që ata mbulojnë.

### Neni 3

#### Kushtet dhe procedurat e pranimit

##### 1. Kushtet e pranimit

Për t'u pranuar në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë ("Master i Shkencave", "Master i Arteve të Bukura", "Master Profesional", kandidati duhet të plotësojë keto kushte:

1.1. Te ketë mbaruar Ciklin e Parë të Studimeve në programin përkatës mësimor (Bachelor në KMDP, Interpretim). Do këne përparësi ato me mesatare 8.0.

1.2. Në Programin e Studimeve të Ciklit të Dytë ("Master i Shkencave", "Master i Arteve të Bukura", "Master Profesional" )

1.2.1. Studentet që kanë mbaruar mbaruar Ciklin e Parë të Studimeve (Bachelor) në programet mesimore të interpretimit, duhet të kryejnë më parë një Master profesional 1 vjeçar (se paku

60 kredite) në lëndet teorike të formimit të ngushtë dhe të formimit karakterizues profesional.

Për studentët e huaj, përveç kritereve të përshikuara në pikën 3.1.1; 3.1.2; 3.1.3; 3.1.4. të këtij Neni, përfshihet edhe njohja e gjuhës shqipe.





## 2. Procedurat e pranimit

2.1. Komisioni i pranimit të kandidatëve për Programin e Studimeve të Ciklit të Dytë ("Master i Shkencave", "Master i Arteve të Bukura", "Master Profesional") ngrihet nga Dekanati i Fakultetit të Muzikës, i cili detajon edhe procedurat specifike të pranimit.

2.2. Procedurat e regjistrimit pranë Fakultetit të Muzikës për në Programin e Studimeve të Ciklit të Dytë ("Master i Shkencave", "Master i Arteve të Bukura", "Master Profesional") dhe të verifikimit të origjinalitetit dhe autenticitetit të dokumentacionit të paraqitur përcaktohen në Rregulloren e Studimeve të Universitetit të Arteve.

2.3. Ankimimi ndaj vendimit të Komisionit të Pranimit bëhet pranë Dekanatit të Fakultetit të Muzikës brenda pesë ditësh nga data e shpalljes së vendimit të pranimeve.

### Neni 4

#### Kohëzgjatja dhe struktura

1. Programi i planifikuar për Studimet e Ciklit të Dytë ("Master i Shkencave", "Master i Arteve të Bukura", "Master Profesional") kryhet në një shtrirje kohore prej katër semestrash mësimorë me sistemin me shkëputje nga puna.

2. Programi studimit është i organizuar në module dhe vlerësohet në kredite (ECTS).

3. Sasia e ECTS të domosdoshme për të kryer të plota Studimet e Ciklit të Dytë ("Master i Shkencave", "Master i Arteve të Bukura", "Master Profesional") është 120 (njëqint e njëzete).

4. Sasia e ECTS të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 (gjashtëdhjetë).

5. Përmbajtja e programit shtjellohet në leksione, seminare, praktika mësimore, dhe forma të tjera të zhvillimit të mësimit e punë individuale.

6. Struktura mësimore e vitit dhe orari i mësimit hartohen në përputhje me planin mësimor, grupet mësimore, numrin dhe kapacitetin e auditorëve, duke synuar një shpërndarje të





drejtpeshuar të ngarkesës ditore në auditor të studentit. Ngarkesa javore në auditor të studentit është mesatarisht 20-25 orë/jave.

#### Neni 5

#### Kurset, Grupet mësimore dhe orët individuale

1. Në Programin e Studimeve Ciklit të Dytë puna mësimore zhvillohet në baze grupi, kurse dhe orë individuale duke respektuar specifikat e formave të zhvillimit të mësimin në Fakultetin e Muzikës (FM) të përcaktuara në Nenin 6 të kësaj Rregulloreje.

2. Monitorimi i procesit mësimor, në FM realizohet nëpërmjet respektimit të orarit mësimor, planeve kalendarike, flete-pranive dhe regjistrave të çdo punonjësi mësimor.

3. Ndarja e ngarkesës mësimore bëhet prej Departamenteve përkatës dhe miratohet nga Dekani.

4. Ndarja e studenteve në kurse, grupe dhe orë individuale, fiksohet në regjistrat e vitit, të cilët janë dokumente zyrtare ku evidentohet zhvillimi i orëve të mësimin nga pedagoget. Ky dokument ruhet nga sekretaria mësimore dhe kontrollohet nga Departamentet dhe K/Sekretarja e FM-së. Regjistri u jepet mesimdhënësve pas çdo orë mësimin për të plotësuar temën e mësimin përkatës. Humbja apo mosplotësimi i regjistrin ngarkon me përgjegjësi shkaktarin.

#### Neni 6

#### Format e zhvillimit të mësimin

Përveç leksioneve, në Fakultetin e Muzikës zhvillohen edhe këto forma të veçanta mësimin:

1. **Atelier.** Në FM kjo formë e mësimin i përgjigjet standartit Ushtrim/Seminar (U/SE) dhe përdoret në dy forma:

1.a. **Atelier në grupe të vogla (AGV – U/SE).** Përdoret në:

1.a.1. Lëndet karakterizuese profesionale si: Muzikë dhomë, Shoqërim Vokal& Instrumental, Panel për instrumentat e frymes, Praktike në grupe specifike etj.





1.a.2. Lëndët me përzgjedhje që plotësojnë njohuritë praktike të studentit si: Klase xhazi, Perkusion xhazi, Kitare elektrike, Saksofon, Muzika e Lehtë & Popullore etj

1.b. **Atelier në grupe të mëdha (A – U/SE).** Kjo formë përfshin mesimdhënien me karakter teoriko-praktik në grupe relativisht të mëdha ose të mëdha studentësh si: Orkestër simfonike, Orkester harqesh, Orkestër frymore, Big-Band, Panel për instrumentat e frymës, Klasë Opere, Kor vajzash/djemsh.

2. **Mësim individual (MI).** Në FM kjo formë e mesimit i përgjigjet standartit "as leksion – as seminar"<sup>1</sup> dhe përdoret në lëndët e mëposhteme: Program kryesor i studimit (kompozim, muzikologji, dirizhim orkestral, dirizhim koral, dirizhim bande, instrumente, kanto), Praktikë në orkester (progr. Dirizhim), Praktikë në kor (progr. Dirizhim), Praktikë në bandë (progr. Dirizhim), Klavijembal dhe muzikë baroke, Lexim partiture (Shek.XX-te), Dëshifrazh II (shek. XX).

3. **Mësim profesional në grupe të vogla (MPGV).** Në FM kjo formë e mesimit i përgjigjet standartit "as leksion – as seminar"<sup>2</sup> dhe përdoret në lëndët e mëposhteme: Program kryesor studimi (Kompozim, Muzikologji në rastet kur behet mesim në grup), Program kryesor studimi (orët që bëhen me pianiste), Analize repertori specifik.

4. **Leksion (LE).** Në FM kjo formë e mesimit i përgjigjet standartit LE dhe përdoret në lëndët që e alternojnë leksionin me forma kontrolli si: Semiotika Muzikore, Histori e muzikes (gjysma e II e shek.XX-te), Histori dhe metodat e analizës, Histori e mendimit teorik, Histori e shkrimit muzikor (Paleografi e përgjithshme), Histori e shkrimit muzikor (Paleografi e përgjithshme), Metodikë e punës studimore, Histori e Estetikës, Hyrje në Menaxhim Projekt.


5. **Praktikat.** Në FM kjo formë e mesimit i përgjigjet standartit Praktikë Mësimore/Praktikë Profesionale:

5.a. **Praktika mësimore (PM).** Në FM kjo formë e praktikës përfshin plotësimin praktik të dijeve të lendeve me karakter pedagogjik dhe kryhet brenda (Praktikë në pedagogji vokale, Praktikë në pedagogji instrumentale, Pjesëmarrje), ose jashtë FM (Praktikë pedagogjike, Praktikë mësimore për progr. i Pedagogjise muzikore). Praktika mësimore është e detyrueshme

<sup>1</sup> Udhëzimi MASH, nr. 25, dt. 02.08.2010 "Dësta shtesa në Udhëzimin nr. 20 dt. 09.03.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik në Institucionet publike të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, pika 1, paragrafi 3

<sup>2</sup> Po aty.





**5.b. Praktika Profesionale (PP).** Në FM kjo formë e praktikës përfshin plotësimin praktik të dijeve të lendeve profesionale dhe zhvillohet në këto lloje:

**5.b.1. Praktikë Artistike (PA).** Në FM, PA zhvillohet në formën e koncerteve brenda apo jashtë FM, është e detyrueshme dhe ndahet në Praktikë Solistike (PS) dhe Praktika në grup ose veprimtari (PG/V).

**PS** është një koncert-recital dhe vlerësohet me 3 (tre) kredite.

**PG/V** është një koncert në grup (muzikë dhomë, ansamble me të mëdha) ose pjesëmarrje me një solo në një koncert të përbashkët dhe vlerësohet me 1 (një) kredite

**5.b.2. Praktikë me Trupa Profesioniste (PTP).** Në FM, PTP zhvillohet në formën e pjesëmarrjes në koncerte me trupa profesioniste jashtë FM. Është praktikë me përzgjedhje dhe vlerësohet sipas rolit që luan studenti në ansambllin/orkestren/korin ku merr pjesë.

Në këto praktika, studenti që luan si solist me një trupë profesioniste vlerësohet me 3 (tre) kredite. Studenti që është pjesëtar i ansambllit/orkestrës/korit profesionist vlerësohet me 1 (një) kredit për praktikë.

PTP mund të zhvillohen edhe më shumë se një në vit. Për të shmangur problemet me praninë e detyruar në leksione, organizimi i tyre kryhet nëpërmjet Dekanatit të FM, në marrëveshje me trupat profesioniste dhe duke zbatuar një regjim kontraktual.

**5.b.3. Praktikë kërkimore-shkencore (PKSH).** Në FM, PKSH zhvillohet nëpërmjet aktivizimit të studenteve të programit të muzikologjisë dhe pedagogjisë në tryeza të rrumbullakta brenda UA (diskutime të veprave të studenteve-kompozitorë, simpoziume, kërkime arkivore etj.).

Studentet që marrin pjesë në këto ngjarje në mënyrë aktive (me referate apo diskutime të shkruara) vlerësohen 3 kredite. Të tjerët vlerësohen si në rastin e Pranisë. Këto praktika janë të detyruara.





5.b.4. **Praktikë në ngjarje shkencore (PNJSH).** Në FM, PNJSH zhvillohet me anën e pjesëmarrjes së studentëve në masterclasse (si degjuës apo në mënyrë aktive), ose në konferenca, simpoziume, kongrese apo ngjarje të tjera lokale, kombëtare apo ndërkombëtare (studentët e muzikologjisë, si degjuës ose me kumtesa apo referate).

Studentet që marrin pjesë në këto ngjarje në mënyrë aktive (me referate apo diskutime të shkruara) vlerësohen 3 kredite. Të tjerët vlerësohen si në rastin e Pranisë. Këto praktika janë me përzgjedhje.

**6. Pjesëmarrje (Prani) (PR).** Në FM, studenti mund të marrë pjesë vetëm me detyrimin e të qenit i pranishëm në lëndë jashtë programit të tij të studimit, në konferenca, simpoziume, kongrese apo ngjarje të tjera lokale, kombëtare apo ndërkombëtare. Në këto raste forma e vetme e vlerësimit është mbledhja e orëve të pranisë (gjatë vitit ose përgjatë një cikli të studimit) dhe llogaritja e tyre me kredite.

Pjesëmarrja mund të jete edhe në më shumë se sa në një lëndë (masterclass, konference, simpozium, kongres apo ngjarje tjetër lokale, kombëtare apo ndërkombëtare) në vit.

7. Departamentet, me miratim të Dekanit, mund të përcaktojnë, përpara fillimit të vitit të ri akademik, edhe forma të tjera të mesimdhënis dhe kontrollit të dijeve të fituara.

8. Pas miratohet nga Këshilli i Fakultetit, këto forma të reja i bëhen të ditura studentëve nëpërmjet shpalljes së tyre 5 ditë përpara fillimit të vitit të ri akademik, si dhe nëpërmjet informimit të drejtpërdrejtë të grupeve të studentëve në ditët e para të vitit të ri akademik. Menyra e organizimit të këtij informimi përcaktohet nga Departamentet me miratim të Dekanit.

## Neni 7

### Detyrimet e studenteve

Gjatë realizimit të këtij cikli mësimor studentet janë të detyruar t'i nënshtrohen rregullorës së programit mësimor, si edhe disa kërkesave baze, ndër të cilat:





1. Ndjekja e detyrueshme e aktivitetit mësimor në masën 75%. Kur studenti me ose pa arsye, nuk merr pjesë në mbi 25% të numrit të seancave të zhvilluara në një lëndë, shpallet i paklasifikuar dhe nuk lejohet të shlyeje detyrimet e metejshme të asaj lende. Ai është i detyruar të ndjehet perseri format e mesimit në vitin pasardhës me të njëjten detyrë frekuentimi.

2. Pjesëmarrja e studentit evidentohet rregullisht dhe monitorohet nepërmjet Flete-Pranise dhe regjistrit të kursit, grupit. Sekretaria mësimore monitoron rregullisht frekuentimin e studentëve në aktivitetet mësimore, evidenton çdo shkelje të kufijve minimale të pranuar në bazë të raportimit të pedagogut të lendes, dhe informon rast pas rasti në dekanat për shkeljet e konstatuara.

3. Ankesat e studentëve lidhur me evidentimin e frekuentimit të orëve të mesimit do të merren në konsideratë për t'u shqyrtuar, nëse paraqiten brenda dy ditësh nga dita të ciles i referohet ankimi.

4. Plotësimi i jo më pak se i 120 krediteve

5. Në përputhje me Strukturën Mësimore të Studimit e Ciklit të Dytë ("Master i Shkencave", "Master i Arteve të Bukura", "Master Profesional") në KMDP dhe Interpretim dhe në marrëveshje me Universitetin e Tiranës dhe Fakultetet e tjera të UA, kreditet e disa lëndëve të detyruara ose me perzgjedhje do të merren pranë Institucioneve përkatëse.

6. Përbushja e detyrimeve mësimore që përcaktojnë specifikat e lëndëve (punimet dhe detyrat e kursit, shlyerja e seminareve etj.).

7. Përcaktimi i fushës së ngushtë të studimit qysh në fillim të studimit

#### Neni 8

#### Format e kontrollit

1. Në Programin e Studimeve Ciklit të Dytë (Master i Arteve të Bukura në Interpretim Muzikor), sipas specifikave të lëndëve të ndryshme, përdoren këto forma kontrolli të dijeve:

1.1. **Detyrë klase** (Lexim partiture - Shek. XX, Analize e repertorit specifik, Historia instrumenteve të muzikës, anglishte e përparuar)

1.2. **Detyrë kursi** (Historia dhe metodat e analizës, histori e estetikës, Semiotika muzikore, Metodika e punës studimore, Menaxhim projekti)





- 1.3. **Seminar** (Historia e muzikes - gjysma e dyte e shek. XX, Historia e estetikës, Historia instrumenteve te muzikes)
  - 1.4. **Kontroll semestral** (Programi kryesor, Lexim partiture - Shek. XX, Analizë e repertorit specifik,)
  - 1.6. **Kontroll vjetor** (Praktikë artistike, Pjesëmarrje, Anglishte e përparuar, Historia e artit, Praktikë me trupa profesioniste, Klase xhazi, Perkusion, metodika e punës studimore, analize e repertorit specifik, Historia e shkrimit muzikor I -Paleografi e përgjithshme, Instrumentet popullore shqiptare, Hyrje ne sociologji)
  - 1.7. **Provim** (Programi kryesor, Semiotika muzikore, Historia dhe metodat e analizës, Historia e muzikes - gjysma e dyte e shek. XX, Lexim partiture - Shek. XX, Analize e repertorit specifik, Metodika e punes studimore, Historia e estetikës, Filozofi, Historia e letersise)
  - 1.8. **Mbrojtje e diplomës/mikrotezës** (Programi kryesor)
2. Format e mesipërme te kontrollit zhvillohen ne këto menyra:
- 2.1. **Kontrolle të dijes/provime me shkrim** (Historia dhe metodat e analizës, Historia e estetikës, Historia instrumenteve te muzikës, Anglishte e përparuar, Historia e artit, Instrumentet popullore shqiptare, Hyrje ne sociologji, Filozofi, Menaxhim projekti, Historia e letersise, Historia e shkrimit muzikor I, Historia e muzikes (gjysma e dyte e shek. XX),
  - 2.2. **Kontrolle të kombinuara/ provime me shkrim dhe me gojë** (provimi me shkrim eshte parakusht per te hyre ne provimin me goje) Semiotika muzikore, Analize e repertorit specifik, Metodika e punes studimore).
  - 2.3. **Kontroll/provim praktik** (Lexim partiture, praktika ne kor/orkester/bandë, Praktikë me trupa profesioniste, Klasë xhazi, perkusion)







**2.3. Provimi i speciales** i cili konsiston ne vleresimin e realizimit artistik profesional dhe teknik te programit.

3. Mënyra e organizimit te kontrollit te dijes është në funksion te natyres se disipline. Ajo përcaktohet nga titullari i lëndës në bashkëpunim me Pergjegjesit e Departamentit dhe miratohet nga Dekani.

4. Në formën e kontrollit me shkrim, provimet bëhen të sekretuara.

5. Tezat e provimit, ne të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari/et i/e lëndes së bashku me asistentin/ët e tij dhe miratohen e nenshkruhen nga Pergjegjesi i Departamentit.

7. Format e kontrollit te dijeve pasqyrohen në Strukturën Mësimore te Programit të Studimit e cila shpallet dhe i behet e ditur studenteve deri ne dy jave para fillimit te vitit

#### Neni 9

#### Vleresimi


1. Vlerësimi i përmbajtjes se Programit te Studimeve të Ciklit të Dyte bëhet me kredite.

2. Vleresimi i provimeve, firmave dhe praktikave të Programit te Studimeve të Ciklit të Dyte behet me nota, si me poshtë:

shumë mirë	= nota mesatare 9 - 10
mirë	= nota mesatare 7 - 8
mjaftueshëm	= nota mesatare 5 - 6
pakalueshëm	= nota

3. Forma e vleresimit shprehet në planin mësimor te lëndes; mënyra e organizimit te provimit dhe pesha qe ze çdo element në vlerësimin perfundimtar shprehen ne programin e lëndës dhe i bëhen të ditur studentit që në fillim te semestrit.





#### Neni 10

##### Parakushtet për hyrje në provim

1. Studenti fiton të drejtën të futet në provimin e një lënde, kur:
  - a. ka shlyer të gjitha detyrimet e lëndës përkatëse. Shlyerja e detyrimeve të lëndës përgjate sezonit të provimeve nuk lejohet.
  - b. e lejon grafiku i ndërvaresisë së lëndëve;
  - c. plotëson kushtet që lidhen me frekuentimin e formave mesimore;
  - d. është regjistruar në sekretarinë mesimore për dënie provimi në sesionin dhe datën përkatëse;
  - e. ka paguar tarifen e shkollimit;
2. Studenti i cili nuk plotëson këto parakushte nuk lejohet të hyjë në provimin e lëndës përkatëse.

#### Neni 11

##### Sezonet e Provimeve

1. Provimet zhvillohen brenda periudhave të caktuara në strukturën mesimore të vitit akademik.
2. Datat e tyre propozohen nga Departamentet, miratohen nga Dekani dhe shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sezonit.
3. Provimet zhvillohen në tre sezona: sezoni i provimeve të dimrit; sezoni i provimeve të verës; sezoni i provimeve të vjeshtës.
4. Sezoni i provimeve të dimrit zhvillohet pas përfundimit të semestrit të parë. Sezoni i provimeve të verës zhvillohet pas përfundimit të semestrit të dytë. Sezoni i vjeshtës zhvillohet në Shtator.
5. Studenti, nuk lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde, brenda një sezoni.





6. Studenti nuk mund të hyjë në të njëjten ditë në dy provime në lënde të ndryshme.

## Neni 12

### Kontrollet e dijes/Provimet

#### 1. Kriteret

1.1. Kalendari i kontrolleve të dijes/provimeve përcaktohet prej Zv/Dekanit të FM në bashkëpunim me pedagogët dhe rradhën hierarkike (përgjegjësi i Grupit Mesimor, përgjegjësi i Departamentit), koordinohen prej përgjegjësit të degës mesimore dhe miratohen prej Dekanit.

1.2. Komisionet e kontrolleve të dijes/provimeve propozohen prej Përgjegjësve të Departamenteve dhe miratohen prej Dekanit.

1.3. Komisionet e kontrollit të dijes/provimit të lëndës përbëhen nga jo më pak se dy pedagogë: titullari/ët e lëndës dhe asistentët përkatës. Nëse nuk plotësohet numri i nevojshëm i komisionit të provimit, Përgjegjësi i Departamentit, me miratim të Dekanit, cakton një pedagog të një discipline të afert. Nëse ndonjë prej titullarëve të lëndës ose asistenti i tij, për arsye madhore nuk mund të marrin pjesë në provim, Përgjegjësi i Departamentit me miratim të Dekanit cakton, me shkrim, punonjësit që do t'i zëvendësojnë. Në rast pamundësie zëvendësimi, me vendim të dekanit, provimi shtyhet jashtë sezonit brenda 5 ditëve të përfundimit të sezonit.

1.4. Kontrollet e dijes/provimit bëhen të hapura dhe duke shfrytëzuar sallat e UA dhe të FM.

1.5. Në kontrollet e dijes /provimit studentët duhet të luajnë të tërë repertorin e parashikuar në program.

1.6. Kontrollet e dijes/Provimit organizohen sipas viteve të ciklit studimor (viti I, viti II).

1.7. Si rregull, orari dhe komisionet e kontrolleve të dijes /provimeve bëhen publike (afishohen në vendet e përcaktuara prej Dekanatis) të pakten një muaj përpara fillimit të Sezonit. Ndryshimi i orarit të kontrolleve të dijes /provimeve bëhet vetëm për arsye të jashtëzakonshme (semundje etj.).

1.8. Kontrollet teknike janë çeshtje të brendshme të Seksioneve. Organizimi apo veprimet e tjera lidhur me to, bëhen me miratimin e Përgjegjës të Departamentit dhe të Dekanit.



1.9. Provimi i speciales nuk mund të kryhet në vjeshtë. Kjo gjë shkon paralel me Diplomat (speciale) që kanë vetëm dy sezona: dimër+verë.

1.10. Vlerësimet kryhen sipas "Kritereve të Vlerësimit" të përcaktuara prej Seksioneve dhe Departamenteve dhe të miratuara prej Dekanit.

1.11. Pas mbarimit të Sezonit përkatesë përfundimet e provimeve afishohen publikisht.

## **2. Procedurat**

2.1. Studenti është i detyruar të paraqitet në provim me dokument identifikimi me fotografi (libreza e studentit/karta e identitetit etj). Në të kundërt ai nuk lejohet të hyjë në provim dhe pasojat rëndojnë mbi studentin. Në përfundim të provimit, kryetari i komisionit shënon në librezën e studentit notën e vlerësimit me numër e me fjale dhe anëtarët e komisionit firmosin.

2.2. Në provim nuk lejohet mbajtja dhe përdorimi i celulareve. Studenti që në provim përdor forma e mjete të pajueshme, largohet nga provimi dhe konsiderohet i vlerësuar negativisht (pakalues).

2.3. Provimet me shkrim bëhen të sekretuar dhe zgjasin 2-4 ore. Gjate provimit mund të lejohet përdorimi i mjeteve ndihmëse. Sistemi i pikeve dhe konvertimi përkatesë me note, që përdoret në provimin me shkrim, i bëhet i njohur studentit para fillimit të tij.

2.4. Në provim nuk mund të hyjnë persona të jashtëm, me përjashtim të Drejtuesit të Departamentit, dhe personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani ose Rektori për të kryer kontroll, përveç rasteve kur Këshilli i Fakultetit, në bazë të specifikës e përcakton ndryshe.

2.5. Në të gjitha format e organizimit të provimit, studentit merr vlerësimin përkatesë nga komisioni jo më vonë se tre ditë pune nga data e dhënies së provimit. Në raste të jashtëzakonshme shtyrja e dhënies së rezultatit bëhet me vendim të Dekanit.

2.6. Komisioni shpall rezultatet e vlerësimit, përpara plotësimit të Fletës së provimit. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara apo regjistrimet (kur ka) të studentit me tezen e zgjidhur.





2.7. Provimet e studentëve ruhen në departament për një periudhë njëvjeçare.

### Neni 13

#### Vlerësimi dhe procedurat e animimit

1. Studenti merr vlerësimin kalues në një lëndë kur vlerësohet me note kaluese sipas formës së kontrollit që parashikon programi.

2. Vlerësimi i provimeve, firmave dhe praktikave të Programit të Studimeve të Ciklit të Dytë (Master i arteve të bukura në Interpretim Muzikor) bëhet sipas Nenit 9, Pika 2 të kësaj rregulloreje.

3. Në rast se ndaj studentit janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose është bërë vlerësim i pamërituar për përgjigjen/performancën artistike, ai ka të drejtën e ankimit. Ankesa duhet të depozitohet me shkrim në Dekanat brenda 48 orësh nga shpallja e rezultatit.

4. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekanati, i cili mund të thërrasë për sqarim komisionin e provimit dhe vetë studentin dhe, pas gjykimit të çështjes, merr vendim përkatës të formës së prerë brenda tre ditëve.

5. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studentin është ankuar dhe vendos që provimi të ripërsëritet, me një komision të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda ose jashtë sesionit, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sesionit përkatës të provimeve.

6. Në komisionin e plotësuar duhet të marrë pjesë edhe përgjegjësi i departamentit, për të monitoruar transparencën e procesit.

### Neni 14

#### Dokumentimi i vlerësimit të studentëve.

1. I vetmi dokument shkollor, që lejon studentin të hyjë në provim dhe dokumenton vlerësimin që ai merr, është Fleta e Provimit.



2. Mënyra e përdorimit të Fletës së Provimit përcaktohet në Rregulloren Mësimore të UA për Ciklin e Dytë të Studimeve

#### Neni 15

##### Përmirësimi i notave

1. Studenti ka të drejtë të kërkojë të përmirësojë notën.
2. Procedurat për përmirësimin e notes, përcaktohen në Rregulloren Mësimore të UA për Ciklin e Dytë të Studimeve.

#### Neni 16

##### Kushtet e kalimit në vitin pasardhës

1. Për të kaluar nga viti i Parë në vitin pasardhës, studenti duhet të ketë grumbulluar të paktën 60% të ECTS (36 ECTS).
2. Studenti persërites ka keto të drejta e detyrime:
  - a. I njihen të gjitha detyrimet e shlyera kur programet e lendeve përkatëse janë të pranueshme për vitin në vazhdim
  - b. Mund të frekuentoje lëndet për të cilat është vlerësuar mbetës dhe është i detyruar të frekuentoje lëndet, për të cilat ka detyrim frekuentimin.
  - c. Duhet të shlyeje detyrimet e reja që lindin për shkak të ndryshimit të planit të programeve mësimore.
  - d. Duhet të paguajë tarifën e shkollimit.

#### Neni 17

##### Bartja

1. Ndër lëndët e formimit bazë dhe lëndët e formimit të përgjithshëm profesional mund të barten vetëm provimet e atyre lendeve të cilat e mbyllin ciklin e studimit të tyre në një semestër (bartje semestrale) apo në një vit (bartje vjetore). Mund të barten gjithashtu edhe provimet e atyre lendeve të cilat, në semestrin apo vitin përkatës janë në fazën e tyre mbyltese.





2. Semestri/viti/pjesa e parë e lëndëve që janë në vazhdimësi por që ndahen në semestra/vite/pjesë për arsye të kohës me të gjatë që kërkon nxenia e tyre (vështro pikën 13), nuk mund të bartet.

#### Neni 18

##### Transferimi i studimeve në të njëjtin program studimi

1. Fakulteti i Muzikës pranon transferime studentesh në Ciklin e Dytë të studimit në vite të ndërmjetme nga një program studimi në tjetrin dhe nga akademi, universitete, konservatore dhe shkolla të tjera arti, brenda ose jashtë vendit, si dhe lejon largimin e studentëve të tij për në shkolla të tjera.

2. Proçedurat për transferimin e studimeve përcaktohen në Rregulloren Mesimore të UA për Ciklin e Dytë të Studimeve.

#### Neni 19

##### Ndërprerja e studimeve, largimi

1. Studenti mund të ndërprejë studimet për një periudhë kohore të caktuar ose mund të largohet përfundimisht nga FM.

2. Proçedurat për ndërprerjen e përkohëshme ose përfundimtare të studimeve përcaktohen në Rregulloren Mesimore të UA për Ciklin e Dytë të Studimeve.

#### Neni 20

##### Mënyrat e diplomimit

1. Studenti mund të përfundojë kursin e studimeve dhe të mbrojë punimin e diplomës brenda afateve normale të studimeve ose tej kufirit që përcakton ky afat të shprehur në rregulloret e Fakulteteve.

2. Studenti nuk mund të mbrojë diplomën shlyer me parë të gjithë detyrimet dhe pa fituar numrin e ECTS siç parashikohen nga planet dhe programet mesimore të çdo programi studimi, si dhe pa likujtuar të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me UA bibliotekën shkencore, etj.





3. Fakultetet perkatese, brenda semestrit te pare te vitit të dyte akademik, ne bashkëpunim me Departamentet dhe drejtuesit e grupeve mesimore shpallin programet, temat dhe drejtuesit e diplomës për çdo student.

4. Diploma e Programit të Studimeve të Ciklit të Dytë ("Master i Shkencave", "Master i Arteve te Bukura", "Master Profesional") paraqitet me një koncert publik me orkester/kor/bande.

5. Vlerësimi i Diplomës bëhet me sistemin e pikeve si më poshtë:

100% - 80% e pikeve te mundeshme	= shume mire
79% - 65% e pikeve te mundeshme	= mire
64% - 50% e pikeve te mundeshme	= mjaftueshem
49% e më pak të pikeve të mundeshme	= pakalueshem

6. Vlerësimi i Diplomes behet edhe me sistemin e notave si më poshte

shumë mirë	= nota mesatare 9 - 10
mire	= nota mesatare 7 - 8
mjaftueshem	= nota mesatare 5 - 6
pakalueshem	= nota 4

7. Ne perfundim te studimeve, studentët pajisen me diplomën programit te studimit perkates sipas modelit të miratuar të diplomës të percaktuar në statutin e UA.

Neni 21

Te fundit

1. Mbi bazen e kesaj Rregulloreje, titullaret e lendëve dhe përgjegjesit e grupeve mesimore mund t'i propozojnë përgjegjesit te Departamentit të KMDP shtojca apo ndryshime me rregulla më te hollësishme që lidhen në mënyre specifike me procedurat e realizimit te procesit mesimor të Programit të Studimeve të Ciklit të Dytë.

2. Këto shtojca hynë ne fuqi me miratimin e Dekanit dhe Keshillit te Fakultetit.







REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKES

Adresa: Blv "Dëshmoret e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri, Tel +355 42 247 596, [www.uart.edu.al](http://www.uart.edu.al)

MIRATOHET

Rektori

Prof. Petrit Malaj

KRITERET E KONKURSEVE TË PRANIMIT

në

Fakultetin e Muzikës në UA

Viti akademik 2013 – 2014

*Tiranë, 2013*





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKES

Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit" Sheshi "Nana Tereza" Tiranë Shqipëri Tel: +361 42 247 896 www.arte.edu.al

Nr. Prot. 163

Tiranë, më 27/03/2013

## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në FM

Viti akademik 2013 - 2014

### 1. Programi mësimor: MUZIKOLOGJI

#### A. Dispozita të përgjithëshme

1. Konkursi për programin e muzikologjisë zhvillohet në dy faza.

#### B. FAZA E PARË

1. Kjo fazë përfshin provat me shkrim në disipinat Sofezh dhe Harmoni.
2. Vleresimi maksimal për secilen nga provat është 30 pike (gjithsej  $30 \times 2 = 60$  pikë).
3. Kohezgjatja për secilen prej provave të mëposhteme është 1 orë e 30 minuta për secilen.
4. Të gjitha provat e kësaj Faze mbështeten mbi kërkesat e silabuseve teorike të shkollës së mesme profesionale.

#### a. Prova e solfezhit:

1. Diktat ritmik në meter dyjësues dhe trejësues (meter i thjeshtë dhe i përberë) me figura deri në përdorimin e vleres gjashtëmbëdhjetëshe.
2. Diktat melodik me një ze në kufinjte e harmonisë tonale, pasuruar me shmangie dhe modulacione të grades së parë.
3. Diktat melodik me dy zëra me një nivel të lehtë vështiresie, brenda kufinjve të harmonisë tonale.
4. Identifikim përmes degjimit të kuintakordeve e septakordeve dhe permbysjeve të tyre.
5. Përcaktimi i pikeve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit





## **b Prova e harmonisë**

1. Prova e Harmonisë përmban dy ushtrime me shkrim si me poshte:

1.1. harmonizim i nje melodije te dhene

1.2. harmonizim i nje basi te dhene

2. Përcaktimi i pikeve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimiit

## **C. FAZA E DYTË<sup>1</sup>**

1. Të gjitha provat e kesaj faze lidhen drejtpesdrejti me kerkesat e programit mesimor te Muzikologjise.

2. Vleresimi maksimal per provat e fazes se dyte eshte 180 pike.

3. Përcaktimi i pikeve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimiit

**C.1. Analizë muzikore me shkrim** e një kohe sonate, te perzgjedhur nga komisioni prej listës së meposhtme:

- Ludwig van Beethoven: Sonata per piano Nr. 1, koha I, Fa - (Vol. I)

- Ludwig van Beethoven: Sonata per piano Nr. 2, koha II, Re+ (Vol. I)

- Ludwig van Beethoven: Sonata per piano Nr. 2, koha III, La + (Vol. I)

- Ludwig van Beethoven: Sonata për piano Nr. 5, koha I, Do - (Vol. I)

- Ludwig van Beethoven: Sonata per piano Nr. 10, koha III, Sol + (Vol. I)

## **C.2. Lojë në instrument**

Konkurenti duhet të luajë ne një instrument (mundesisht ne piano), një veper të permasave dhe të nivelit mesatar të veshtrësise.

---

<sup>1</sup> Këto sonata janë të botuara ne Vëllimin e pare të Sonatave te L. v Beethoven-it. Ky vëllim gjendet pranë Bibliotekës së UA



**C.3. Test formues në disiplina teorike të muzikës:** Histori muzike, Analize forme, Folklor Muzikor, Teori elementare e muzikes dhe Harmoni. Testi përfshin 30 pyetje me nga tre mundësi përgjigjeje sipas modelit të mëposhtem:

Vendlindja e Chopin-it është:			Klasicizmi i përket:		
Po	Jo		Po	Jo	
a. Gjermania	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	a. shekullit IV	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Franca	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	b. shekullit XVIII	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Polonia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	c. shekullit XIX	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>





## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në FM

Viti akademik 2013 - 2014

### 2. Programi mësimor: PEDAGOGJI MUZIKORE

#### A. Dispozita të përgjithëshme

1. Konkursi për programin e pedagogjise muzikore zhvillohet ne dy faza.

#### B. FAZA E PARË

1. Kjo faze perfshin provim me shkrim ne disiplinat Sofezh dhe Harmoni.
2. Vleresimi maksimal për secilën nga provat është 30 pike (gjithsej  $30 \times 2 = 60$  pike).
3. Kohezgjatja per secilen prej provave të meposhtëme është 1 ore e 30 minuta per secilen.
4. Të gjitha provat e kesaj Faze mbeshteten mbi kerkesat e silabuseve teorike te shkollës së mesme profesionale.

#### a. Prova e solfezhit

1. Diktat ritmik ne meter dypjestues dhe trepjestues (meter i thjeshte dhe i perbere) me figura deri në përdorimin e vleres gjashtëmbëdhjeteshe.
2. Diktat melodik me një zë ne kufinjte e harmonisë tonale, pasuruar me shmangie dhe modulacione te grades se parë.
3. Diktat melodik me dy zëra me nje nivel te lehte veshtiresie, brenda kufinjve te harmonise tonale.
4. Identifikim permes dëgjimit te kuintakordeve e septakordeve dhe përmbysjeve te tyre.
5. Përcaktimi i pikeve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

#### b Prova e harmonisë

1. Prova e Harmonise permban dy ushtrime me shkrim si më poshtë.





1.1. harmonizim i një melodije të dhënë

1.2. harmonizim i një basi të dhënë

2. Përcaktimi i pikëve për zerat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

### C. FAZA E DYTË

1. Te gjitha provat e kësaj faze lidhen drejtpërdrejt me kerkesat e specialitetit Pedagogji Muzikore.

2. Vlerësimi maksimal për provat e Fazës së dytë është 180 pikë.

3. Përcaktimi i pikëve për zerat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

#### 1. Lojë në instrument

1. Konkurenti duhet të luajë në një instrument një veper të përmasave dhe të nivelit mesatar të veshtrësisë.

2. Vlerësimi maksimal për këtë provë është 60 pikë

2. **Test i përgjithshëm formues, artistik e kulturor:** Histori muzike, Analize forme, Folklor, Teori elementare e muzikës, Harmoni, Letërsi shqiptare dhe botërore, Histori e përgjithshme, Kulture gjuhësore. Testi përfshin 40 pyetje me nga tre mundësi përgjigjeje sipas modelit të mëposhtëm:

Vendlindja e Chopin-it është:			Klasicizmi i përket:		
Po	Jo		Po	Jo	
a. Gjermania	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	a. shekullit IV	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
b. Franca	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	b. shekullit XVIII	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
c. Polonia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	c. shekullit XIX	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKES

Adresa: Blv. Dëshmorët e Kombit - Sheshi "Nënë Tereza" - Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 596 - www.uarte.edu.al

1. Vlerësimi maksimal për këtë provë është 180 pike

DEKANI  
Prof. Sokol Shupo





## Lënda: Kriteret e Konkurseve të Pranimit në FM

Viti akademik 2013 - 2014

### 3. Programi mësimor: KOMPOZIM MUZIKOR

#### A. Dispozita të përgjithëshme

1. Konkursi për programin e kompozimit zhvillohet në dy faza
2. Për programin e kompozicionit parapëlqehen kandidatet të cilët e kanë mbaruar shkollën e mesme për piano, violinë ose violonçel.

#### B. FAZA E PARË

1. Kjo fazë përfshin provim me shkrim në disipinat Sofezh dhe Harmoni.
2. Vleresimi maksimal për secilen nga provat është 30 pike (gjithsej  $30 \times 2 = 60$  pikë).
3. Përcaktimi i pikeve për secilen provë të veçantë kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit
4. Kohëzgjatja për secilen prej provave të mëposhteme është 1 orë e 30 minuta për secilen.
5. Të gjitha provat e kësaj Faze mbështeten mbi kerkesat e silabuseve teorike të shkollës së mesme profesionale.

#### a. Prova e solfezhit

##### a.1. Prova me shkrim

1. Diktat ritmik me ritëm dyqjestues dhe treqjestues (metrike e thjeshtë dhe e përbërë).
2. Diktat melodik me një zë në kufijte e harmonise tonale, pasuruar me shmangie dhe me modulacione të gradës parë.
3. Dëgjime kuintakordesh me përmbysje dhe septakordesh me përmbysje.
4. Diktat melodik me dy zera të një shkalle të lehtë brenda kufinjve të harmonise tonale.







5. Përcaktimi i pikëve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimiit

#### **a.2. Prova me gojë**

b.1. Dëgjime nota teke, intervale, A5 A7 me përmbysje

b.2. Lexim a prima vista, ushtrim ritmik, ushtrim melodik.

b. 3. Përcaktimi i pikëve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimiit

#### **b. Prova e harmonisë**

##### **b.1. Prova me shkrim**

1. Prova e Harmonisë përmban dy ushtrime me shkrim si me poshte:

1.1. harmonizim i nje melodije te dhene

1.2. harmonizim i nje basi te dhene

2. Përcaktimi i pikëve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimiit

##### **b.2. Prova me gojë**

1. Të luajë në piano një skemë harmonike të dhënë

2. Të kryejë analizë harmonike tonale.

3. Përcaktimi i pikëve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimiit

#### **C. FAZA E DYTË**

1. Të gjitha provat e kësaj faze lidhen drejtpërdrejt me kërkesat e programit mesimor të Kompozimit muzikor. Vlerësimi maksimal për këtë fazë është 180 pike.

2. Përcaktimi i pikëve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimiit

##### **C.1. Provat speciale**

###### **a. Punime të kompozuar më parë**

Kandidati për specialitetin e kompozicionit duhet të sjellë me vete 4 krijime të tij të specifikuar në gjinitë si me poshte:



1. Kengë popullore të punuara në kor, solist e piano etj.
2. Romance e thjeshtë për vokal e piano
3. Dy pjesë të gjinive të ndryshme për instrument piçno, violine e piano, ansambel instrumental etj.
4. Përcaktimi i pikeve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

#### **b. Detyrë në klasë**

1. Te krijojë një pjesë instrumentale deri në formën tripjesore me teme të dhëna nga komisioni (pjesa mund të shkruhet për piano dhe ansambel, sipas dëshirës së kandidatit) koha 3 ore.
2. Te improvizojë në instrument (mundësisht në piano) mbi një motiv të dhënë.
3. Përcaktimi i pikeve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

#### **c. Analizë e formave Muzikore**

1. Pyetje teorike mbi organizimet formale në muzikë.
2. Analizë e një vepre të zgjedhur ad hoc nga komisioni.
3. Njohuri të përgjithshme mbi folklorin.
4. Përcaktimi i pikeve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit

#### **d. Histori e Muzikës Shqiptare<sup>1</sup>**

1. Përcaktimi i pikeve për zërat/provat e veçanta kryhet ad hoc nga Komisioni i Pranimit
2. Kandidati duhet të komentojë dhe të analizojë me perzgjedhje ad hoc nga veprat e mëposhtme:

- P. Jakova - Opera "Mrika"; opera "Skenderbeu"  
Ç. Zadeja - Simfonia; Sonata për violine dhe piano

<sup>1</sup> Veprat e poshtshënuara gjenden pranë Bibliotekës së UA





- T. Daja - Balet: "Halili dhe Hajria"; suita "Ditë pikniku"
- L. Dizdari - Trio Nr.1; Sinfonia.
- Sh. Kushta - Poema "Atdheu"; Suita orkestrale Nr.2 -
- K. Laro - Poema simfonike "Baballaret"
- Th. Gaqi - Koncert për violinë, violonçel e orkester; Valle orkestrale
- A. Peçi - Koncert per violonçel e orkester Nr.2; Valle per violine.
- S. Shupo - Suite simfonike (sipas tabllove te K. Buzës).
- H. Zacharian - Rondo per violine

#### e. Histori e muzikës botërore<sup>1</sup>

Studenti duhet te njohë këto vepra të mjeshtrave te medhenj te muzikes boterore:

- J. S. Bach - Preludet dhe fugat nga Wohltemperiertes Klavier vol.1 dhe 2.
- W. A. Mozart - Sonata ne La Mazhor  
- Sonata në Re mazhor  
- Sinfonia në sol minor  
- Sinfonia 2 Jupiter  
- Opera "Dasma e Fagaros"
- L. van Beethoven - Sonatat Nr. 1, 2, 3, 5, 8, 14, 17, 21  
- Sinfonite Nr. 3, 5, 9.  
- Koncertet per piano e orkester Nr.1 dhe 3  
- Koncerti per voline  
- Uvertura "Egmont"

---

<sup>1</sup> Veprat e poshlëshënuara gjenden pranë Bibliotekes së UA



- F. Schubert
- Sonata për piano
  - Sinfonia Nr.8 (e pambaruar)
